



Buletini i Turizmit

Maj 2023

PËRMBAJTJA

TURIZMI

1. VIZITORË TË HUAJ TË HYRË PËR MUAJIN MAJ 2023

1.1 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

1.2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas mënyrës së udhëtimit

1.3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve

2. TURIZMI KULTUROR

3. TURIZMI NATYROR

1. HYRJET E VIZITORËVE TË HUAJ PËR MUAJIN MAJ 2023

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 705.079. Ky numër është rritur me 16,7 %, krahasuar me Maj 2022. Gjatë pesëmuorit të parë 2023, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 2.389.899. Ky numër është rritur me 42,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022

	MAJ 2022	MAJ 2023	NDRYSHIMI NE %	JANAR-MAJ 2022	JANAR -MAJ 2023	NDRYSHIMI NË %
Vizitorët e huaj	604,430	705,079	17%	1,677,691	2,389,899	42%

1.1 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Në lidhje me hyrjen e shtetasve të huaj sipas qëllimit vihet re një rritje e vizitorëve të huaj, që kanë ardhur për arsye personale, si dhe numri i udhëtarëve transit. Kemi ulje për vizitorët që vijnë për arsye shëndetësore dhe qëllime fetare. Më poshtë është tabela e vizitorëve të huaj sipas qëllim të vizitës së tyre, që kanë deklaruar në pikat tona kufitare:

Periudha	Maj 2022	Maj 2023	Ndryshimi në %%	Janar-Maj 2022	Janar- Maj 2023	Ndryshimi në %
Gjithsej	604.430	705.079	16,7	1.677.691	2.389.899	42,5
I. Personale	593.820	692.313	16,6	1.634.146	2.339.038	43,1
Pushime, miq e të afërm. Te tjere	568.041	640.717	12,8	1.559.409	2.206.851	41,5
Shërbime shëndetësore	41	155	278,0	458	350	-23,6
Qëllime fetare	23	33	43,5	175	156	-10,9
Tranzit	25.715	51.408	99,9	74.104	131.681	77,7
II. Biznes dhe profesionale	10.610	12.766	20,3	43.545	50.861	16,8

Burimi INSTAT

1.2 Hyrja e shtetasve të huaj sipas mënyrës së udhëtimit

Hyrtet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Maj 2023, janë 1.230.165. Ky tregues rezulton me një rritje 14,5 %, krahasuar me Maj 2022.

Në tabelën më poshtë jepet lloji i udhëtimit që kanë zgjedhur shtetasit e huaj dhe shqiptarë, gjatë muajit maj 2023, krahasuar kjo me të njëjtën muaj të vitit 2022. Gjithashtu më poshtë jepen dhe të dhënat për 5 mujorin e parë të vitit, e krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës:

Nr.	Mënyra e udhëtimit	Periudha					
		Maj 2022	Maj 2023	Ndryshimi në %	Janar-Maj 2022	Janar-Maj 2023	Ndryshimi në %
1	Me ajër	223.589	280.652	26%	775.049	1,114,621	44%
2	Me det	37.301	45.771	23%	127.434	151,709	19%
3	Me tokë	813.938	903.742	11%	2.551.249	2,900,905	14%

Burimi INSTAT

-Numri i shtetasve që zgjedhin të udhëtojnë me tokë zë 73% të totalit;

-Numri i shtetasve që zgjedhin të udhëtojnë me ajër zë 23% të totalit;

-Numri i shtetasve që zgjedhin të udhëtojnë me det zë 4% të totalit

1.3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve

Në lidhje me shtetësinë e të huajve që kanë vizituar Shqipërinë gjatë kësaj periudhe e gjeni në tabelën e hyrjes së vizitorëve të huaj për nga shtetësia. Siç vihet re dhe nga table shtetasit kosovarë vijojnë të zënë numrin më të madh të shtetasve të huaj që vizitojnë Shqipërinë, kosovarët zënë 39.1% të totalit; Pas tyre vijnë shtetasit nga Mali I Zi e Maqedonia e Veriut. Rritjen më të madhe të muajit Maj me vitin paraardhës e kanë shtetasit me pashaportë Kineze, Spanjolle, Ukrainase, Norvegjeze e nga Finlanda. Më poshtë gjeni tabelën krahasuese për muajin maj dhe krahasimin e pesë muajve të parë të 2023 me vitin paraardhës.

	Maj 2022	Maj 2023	Ndryshimi ne %	Janar - Maj 2022	Janar- Maj 2023	Ndryshimi në %
KOSOVË	245,743	275,930	12%	575,220	960,884	67%
MAQEDONIA E VERIUT	60,951	60,867	0%	212,652	228,600	7%
GREQI	34,684	45,370	31%	157,711	210,596	34%
ITALI	40,994	54,606	33%	154,756	220,441	42%
ANGLI	14,138	17,845	26%	46,006	55,817	21%
MALI I ZI	47,195	63,165	34%	165,735	230,752	39%
POLONI	6,587	12,570	91%	11,075	21,685	96%
SHBA	11,907	13,938	17%	30,804	41,521	35%
SPANJË	2,181	5,508	153%	6,736	14,249	112%
GJERMANI	19,768	38,339	94%	47,552	76,737	61%
ZVICËR	3,787	5,497	45%	14,605	16,813	15%
FRANCA	7,399	11,989	62%	17,734	25,548	44%
AUSTRI	3,833	6,084	59%	9,347	12,908	38%
TURQI	9,771	15,040	54%	27,463	55,014	100%
BULLGARI	3,569	4,378	23%	11,981	14,846	24%
KROACI	3,038	3,344	10%	10,735	12,131	13%
RUMANI	2,067	2,552	23%	6,362	8,026	26%
SLLOVENI	1,210	1,489	23%	3,448	3,891	13%
UKRAINË	2,175	5,048	132%	7,045	12,986	84%
BOSNJE-HERCEGOVINË	2,547	3,273	29%	8,044	10,166	26%
SERBI	7,256	6,753	-7%	25,708	21,677	-16%
HOLLANDË	10,332	6,861	-34%	15,110	15,176	0%
SUEDI	2,905	3,464	19%	6,890	8,921	29%
NORVEGJI	1,074	2,423	126%	2,841	4,694	65%
FINLAND	527	1,154	119%	1,209	2,569	112%
KINE	321	1,127	251%	322	3,400	193%
INDI	817	914	12%	223	2,841	63%
IZRAEL	805	959	19%	656	2,506	35%
RUSI	4,391	2,035	-54%	4,661	6,223	-2%

Burimi INSTAT

2. TURIZMI KULTUROR

Në lidhje me vizitorët në institucionet e kulturës për muajin Maj 2023 vihet re një rritje e numrit të vizitorëve në 12 muzetë e vendit. Kështu kjo rritje është 33% më shumë se muji Maj i vitit 2022. Rritjen më të madhe e kanë vizitorët në 7-të kalatë e vendit, ku rritje është prej 142%. Rritjen më të madhe e ka Manastiri i 40 Shenjtorëve, Kalaja e Himarës dhe parku Arkiologjik i Lezhës. Gjatë kësaj periudhe disa institucione të kulturës janë në proces restaurimi si Kalaja e Beratit; Muzeu Etnografik, Krujë; Muzeu Arkiologjik i Durrësit etj. Më poshtë po japim tabelën e vizitueshmërisë së institucioneve të kulturës të krahasur me vitin paraardhës.

Nr.	EMËTIMI I INSTITUCIONIT	Maj 2022	Maj 2023	Ndryshimi në %	Janar-Maj 2022	Janar-Maj 2023	Ndryshimi në %
1	MUZEU HISTORIK KOMBËTAR TIRANË	5,245	9,293	77%	10,234	18,700	83%
2	MUZEU ARKEOLOGJIK DURRËS	2,081	-	0	4,222	0	-100%
3	MUZEU I PAVARSISË VLORË	264	435	100%	541	1,012	87%
4	MUZEU GJERGJ KASTRIOTI, KRUIJË	8,790	11,673	65%	17,975	25,416	41%
5	MUZEU ETNOGRAFIK, KRUIJË	-	-	33%	513	0	-100%
6	MUZEU ETNOGRAFIK BERAT	1,490	-	100%	2,666	0	-100%
7	MUZEU IKONOGRAFIK ONUFRI, BERAT	4,310	8,161	89%	7,687	14,300	86%
8	MUZEU I ARTIT MESJETAR, KORÇË,	1,033	1,549	50%	1,818	3,366	85%
9	MUZEU ARKEOLOGJIK, KORÇË,	320	90	-72%	434	361	-17%
10	MUZEU ARSIMIT, KORÇË,	1,650	1,936	17%	4,529	5,881	30%
11	MUZEU K. I FOTOGRAFISË MARUBI	1,476	1,998	35%	4,066	4,718	16%
12	MUZEU K. I PËRGJIMEVE " SHTËPIA ME GJETHE"	3,312	4,774	44%	7,687	12,248	59%
TOTALI MUZE		29,971	39,909	33%	63,732	86,002	35%
1	KALAJA BERAT	-	.	-	4,582		-100%

2	KALAJA GJIROKASTËR	8,034	18,486	130%	14,715	33,200	126%
3	KALAJA PORTOPALERMOS	720	970	35%	1,020	1,468	44%
4	KALAJA E KANINËS	160	395	147%	242	723	199%
5	KALAJA E HIMARËS	100	348	248%	188	647	244%
6	AMFITEATRI	2,543	2,707	6%	4,027	5,154	28%
7	MANASTIRI I 40 SHËNJTORËVE	32	140	338%	58	265	357%
TOTALI KALA E MONUMENTE TE TJERE		11,589	28,046	142%	24,832	41,457	67%
1	PARKU KOMBËTAR BUTRINT	7,721	14,371	86%	11,616	21,355	84%
2	PARKUT ARKEOLOGJIK APOLONI	8,845	12,793	45%	14,356	23,119	61%
3	PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS	499	615	23%	1,424	1,891	33%
4	PARKU ARKEOLOGJIK SHKODËR	16,326	21,440	31%	30,926	39,276	27%
5	PARKU ARKEOLOGJIK LEZHË	282	806	186%	1,183	1,818	54%
6	PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA	230	115	-50%	269	248	-8%
7	PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM	382	347	-9%	470	594	26%
8	PARKU ARKEOLOGJIK FINIQ	92	107	16%	109	205	88%
9	PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE	94	209	122%	128	351	174%
TOTALI PARQE ARKEOLOGJIK		34,471	50,803	47%	60,481	88,857	47%
TOTALI NUMRI I VIZIOREVE		76,031	113,758	50%	147,687	216,316	46%

Burimi Ministria e Kulturës

Në lidhje me të ardhurat nga vizitorët në Institucionet Kulturore për këtë muaj rezulton që të jenë përfituar 30,167,210 Lek ose rreth 65% më shumë të ardhura se i njëjti muaj i vitit të shkuar.

3. TURIZMI NATYROR

Të dhënat nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, tregojnë se gjatë muajit Maj 2023 kemi një ulje prej 18 % të vizitorëve që kanë vizituar zonat e

mbrojtura krahasuar me muaji Maj të vitit 2022. Rritjen më të madhe e kanë pasur vizitorët e zonave të mbrojtura për Qarkun e Dibrës me rritje 831%, ndjekur nga vizitorët e zonave të mbrojtura të Qarkut Vlorë me 47%. Më poshtë po japim të dhënat dhe për periudhen Janar–Maj 2023, sipas qarqeve:


QARKU	Vizitorë në Zonat e Mbrojtura (total)			Vizitorë në Zonat e Mbrojtura (total)		
	Janar Maj 2022	Janar Maj 2023	Ndryshimi në %	Maj 2022	Maj 2023	Ndryshimi në %
Tirana	33,526	43,722	30%	7,782	12,552	61%
Vlora	64,605	95,246	47%	24,811	45,770	84%
Lezhë	29,157	33,651	15%	9,453	9,517	1%
Gjirokastrë	19,789	20,874	5%	8,810	4,906	-44%
Kukës	11,255	6,030	-46%	5,864	2,615	-55%
Korçë	512,944	110,026	-79%	108,976	34,464	-68%
Berat	9,869	7,370	-25%	2,857	2,172	-24%
Elbasan	13,551	15,294	13%	3,919	3,835	-2%
Shkodër	83,740	137,635	64%	45,530	39,280	-14%
Dibër	2,341	21,787	831%	499	3,498	601%
Fier	103,710	149,550	44%	35,050	52,550	50%
Durrës	85,650	91,900	7%	27,250	19,800	-27%
TOTAL	970,137	733,085	-24%	280,801	230,959	-18%

Burimi: Agjensia e Zonave të Mbrojtura

Për të parë se cilat kanë qënë Zonat e Mbrojtura më të vizituara gjatë muajit Maj po e japim me paraqitje grafike sipas kategorive.

Kategoria e **Parqeve Natyrore** ka 12 zona të cilat gjatë muajit Maj janë vizituar nga 116,886 vizitorë, prej tyre 65% janë vizitorë vendas dhe 35% vizitorë të huaj. Numri më i madh i vizitorëve vijon të jetë në parkun kombëtar Karavasta Divjakë(37%), Alpet e Shqipërisë nga qarku Shkodër(16%) dhe Parku Kombëtar i Butrintit (12%). Më poshtë gjeni paraqitjen grafike të numrit të vizitorëve në këto zona të mbrojtura të dhëna në përqindjen që zënë kundrejt numrit totalit të vizitorëve në Parqet Kombëtare gjatë këtij muaji:

Vizitorët në Parqet Kombëtare




Në kategorinë **Monumentet e Natyrës**, janë të shpallura 31 zona. Gjatë muajit Maj vizitorë ka pasur vetëm në 24 prej tyre. Këto zona janë vizituar prej 24,016 vizitorë, ku nga këta 74,9% janë vizitorë vendas dhe 25,1% vizitorë të huaj.

Vizitorët me numrin më të madh janë në Monumentin e Natyrës Shpella e Shënandoit (21%) Sarisalltik të Krujës (20%), e cila ndiqet nga Ujrat Termale të Bënjës (15%). Më poshtë po japim në mënyrë grafike numrin e vizitor në grafikun më poshtë:

Vizitorët në Monumentet e Natyrës




Në kategorinë **Rezervatet Natyrore të Menaxhuar dhe Parqet Natyror** janë të përfshira 26 zona, por vetëm në 19 prej tyre ka pasur vizitorë për muajin Maj 2023. Numri I vizitorëve për këtë kategori është 45,375, nga këta 68 % janë vizitorë vendas. Numrin më të madh të vizitorëve për muajin Maj e ka Syri I Kaltër (22%), Qafshatamba me 20% dhe Liqeni I Shkodrës (19%)



Në kategorinë **Peisazh i Mbrojtur** përfshihen 11 zona, por për muajin Maj, ka pasur vizitor vetëm në 7 zona. Numri I vizitorëve që kanë vizituar këto 7 zona është 44,682, nga ku 80 % e vizitorëve janë vëndas. Vizitorët me numrin më të madh janë në Peisazhin e Mbrojtur të Liqenit të Pogradecit (42%), të ndjekur nga vizitorët në Lumin Buna (23%) e Nartë Pishë Poro, Vlorë (20%).

Vizitorët në Peizazhet e Mbrojtura



- Liqeni i Pogradecit
- Bredhi i Drenovës - Sinicë
- Nartë - Pishë Poro (Pish Poro)
- Nartë - Pishë Poro (Nartë)
- Rrushkull
- Lumi Buna - Velipojë
- Bjeshka e Oroshit

Të ardhurat nga Zonat e Mbrojtura për Muajin Maj 2023 janë **682,550** Lek.